

Deklarata e Simpoziumit

Kulturat *in vitro* - nga kërkimi shkencor drejt tregut. Nevoja e krijimit të Rrjetit Virtual Kombëtar të Bioteknologjisë Bimore

Të mbledhur në Simpoziumin Shkencor, ne, partnerët e pranishëm paraqesim këto rekomandime:

1. Rekomandime lidhur me aplikimin e metodave bioteknologjike për shëndetësimin e fidanëve frutorë:

Njohja e rrezikut të patogjenëve të drufrutorëve në Europë për prodhimin e frutave dhe sidomos për fidanët nga ana e specialistëve dhe veçanërisht e fermerëve;

Forcimi i kontrollit i materialit mbjellës, për të shmangur futjen e patogjenëve karantinorë apo shtameve të rinj të tyre. Forcimi i institucioneve përgjegjëse për t'u marrë me emergjenca të reja fitosanitare (përmirësimi i teknikave për mbikëqyrjen e territorit, forcimi i masave të karantinës, përmirësimi në diagnozën e sëmundjeve të bimëve);

Krijimi i rrjeteve shkencore institucionale për t'i bërë ballë nevojave të prodhimit gjithnjë në rritje dhe situatave të vështira fitosanitare që e rrezikojnë atë;

Përfshirja e metodave bashkëkohore të kontrollit fitosanitar të fidanëve duke shkëmbyer përvojën me laboratorët e përparuar në vend dhe në institucione shkencore në rajon dhe në Europë;

Ngritja e programit të certifikimit për njohjen dhe kontrollin fitosanitar e gjenetik të materialit të shumimit dhe harmonizimi i Ligjit Shqiptar të certifikimit me direktivën 2005/43/CE të BE, implementimi nga MBZhRAU në bashkëpunim me UBT;

Përcaktimi i statusit fitosanitar të koleksioneve publike ose private bazuar në një procedurë të rregullt dhe të kontrolluar nga autoritetet e caktuara;

Kontrolli i gjendjes fitosanitare të materialit bimore, i ofruar si shërbim nga laboratorët e certifikuar publikë. Mbulimi financiarisht i certifikimit të laboratorëve publikë të autorizuar nga MBZhRAU;

Mbështetje edhe për prodhim industrial, për qendrat publike si QTTB-Vlorë me riaftësim të laboratorit *in vitro* ose qendra private, për të bërë shumimin e materialit bimore ose të bimëve të përzgjedhura si kandidatë klone, ku duhet të përcaktohet stadi fitosanitar i tyre, dhe kur është e nevojshme të bëhet shëndetësimi i tyre;

Mbështetje për ruajtjen e gjermoplazmës autoktone shqiptare e të Burimeve Primare;

Përdorimi i bimëve të shëndetësuar nga fermerët nëpërmjet një filiere kompetente të prodhimit të fidanëve për shumimin e shpërndarjen e materialit bimor me garantim të ruajtjes së gjendjes fitosanitare të njëjtë me Burimin Primar;

Nxitja e bashkëpunimit midis shoqatave të fidanrritësve me institucionet shkencore për shëndetësimin e kultivarëve lokalë, shumë të kërkuar në tregjet e sotme;

Bashkëpunimi me qendra private për fillimin e ngritjes së laboratorëve komercialë *in vitro*.

2. Rekomandime lidhur me aplikimin e metodave *in vitro* për ruajtjen e gjermoplazmës bimore dhe në përmirësimin gjenetik të bimëve

Mbështetje për ruajtjen e gjermoplazmës bimore në Shqipëri, si detyrë kryesore për gjenetistët dhe seleksionerët, veçanërisht në kushtet e erozionit të theksuar gjenetik;

Përdorimi i metodave *in vitro* të rritjes minimale për ruajtje afat-shkurtër dhe afat-mesëm të gjermoplazmës bimore dhe testim i teknikave të reja të konservimit afatgjatë të kriokonservimit, veçanërisht për ruajtjen e gjermoplazmës së bimëve elite;

Mbështetje për Laboratorin *in vitro* të Qendrës së Resurseve Gjenetike, UBT, si institucion i mirëfilltë shkencor me detyra të koleksionimit, rigjenerimit, shumëzimit, karakterizimit, vlerësimit, studimit e ruajtjes së resurseve gjenetike bimore;

Ngritja e koleksioneve gjenetike *in vitro* pranë QTTB të specializuara për krijimin bërthamave stock dhe pranë Departamenteve në UBT dhe UT;

Përdorimi i teknikave të reja të kulturës *in vitro* e stimulimi i kërkimit shkencor në fushën e përmirësimit gjenetik bimor me përdorimin e këtyre teknikave.

3. Domosdoshmëria e krijimit të Rrjetit Virtual Kombëtar të Bioteknologjisë Bimore një hap drejt kërkimeve bashkëkohore në fushën e bioteknologjisë bimore

Mbështetje institucioneve akademike e shkencore në funksion të punës kërkimore për sigurimin e sinergjisë mes kërkimit shkencor dhe programeve të zhvillimit kombëtar;

Vëmendje arsimimit të të rinjve në shkencat natyrore, teknike, dhe bujqësore, përmes aplikimit të burimeve dhe incentivave të nevojshme;

Krijimi i rrjetit duhet të jetë një mjet për të bashkuar burimet më të mira në potencialet njerëzore dhe të infrastrukturës në vend për të qenë të aftë për vazhdimin e punës dhe për të qenë konkurrues me vende më të zhvilluara të rajonit për stimulimin e bashkëpunimit të institucioneve shkencore dhe të universiteteve për:

- ✓ Harmonizimin e tematikës së kërkimit shkencor dhe pjesëmarrje të përbashkët në programet kombëtare të fushës së bioteknologjisë bimore;
- ✓ Krijimin e konsorciumeve në vend për pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare;
- ✓ Vënien në funksionim të laboratorëve ekzistues, ku janë investuar mjete financiare të konsiderueshme, duke patur edhe ekspertizën e specialistëve brenda dhe jashtë vendit;
- ✓ Shkëmbimin e përvojës pozitive midis grupeve të ndryshme kërkimore;
- ✓ Mbështetjen e doktoraturave dhe masterave, si dhe zhvillimin e kurseve e trajnimeve për studentët e specialistët e tjerë pranë Qendrave të specializuara dhe të kualifikuara në fushën e bioteknologjisë bimore.

Tiranë, më 3 dhjetor 2015

Komiteti Shkencor i Konferencës